



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:208311
Datë: 12.03.2024
Numri i dokumentit: 05438989

Ac.nr.2867/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka - kryetar i kolegjit, Malsor Kryeziu dhe Faton Ademi- anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve A. G, S. K, H.Th, V, S, S. M, të cilët i përfaqëson sipas autorizimit B. P., avokat nga Komuna e Vushtrrisë, Rruga “Dëshmoret e Kombit” p.n., kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme, në Prishtinë, Rruga “Luan Haradinaj” p.n., të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës, me objekt kontesti, kompensim i pagës së trembëdhjetë, shpërblimit jubilar dhe shujtave ditore, lartësia e objektit të kërkesës 13,359.80 euro, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.7583/21, të datës 16.12.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më **12.03.2024**, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET SI E PA BAZUAR, ankesa e të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme me seli në Prishtinë, parashtruar përmes përfaqësueses nga Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.7583/21, i datës 16.12.2022, në pikën **I** dhe **II** të dispozitivit, **VËRTETOHET**.

II. Pika **III** e dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.7583/21, i datës 16.12.2022, **mbetet e pa shqyrtuar**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.4583/21 të datës 16.12.2022, jashtë seancës, ka vendosur si në vijim:

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve A. G, S. K, H. Th , V.S, S. M, DETYROHET e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme në Prishtinë, paditësve t'ua paguaj shumat si në vijim:

- Paditësit të parë A. G, në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, t'ia paguaj për çdo vit shumën nga 335.03 euro, e në total, shumën prej 1,340.13 euro

- Paditësit të dytë S. K, në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, t'ia paguaj për çdo vit shumën nga 588.73 euro, e në total, shumën prej 2,354.92 euro

- Paditësit të tretë H. Th, në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, t'ia paguaj për çdo vit shumën nga 582.45 euro, e në total, shumën prej 2,329.80 euro.

- Paditësit të katërt V. S, në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, t'ia paguaj për çdo vit shumën nga 582.45 euro, e në total, shumën prej 2,329.80 euro

- Paditësit të pestë S. M, në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, t'ia paguaj për çdo vit shumën nga 531.90 euro, e në total, shumën prej 2,127.60 euro

II. DETYROHET e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës, Drejtoria Përgjithshme, në Prishtinë, Rruga "Luan Haradinaj" p.n., të ju paguaj paditësve S. M, shumat e gjykuara si në pikën -I- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me kamatë ligjore në lartësi prej 8 % në vit, e cila fillon të llogaritet nga data 17.09.2021, dita kur është paraqitur padia në këtë gjykatë, e deri në pagesën definitive, dhe shpenzimet e kësaj procedure kontestimore, në shumën prej 724.00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes - pranimi të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

III. REFUZOHET pjesa e kërkesëpadisë së paditësit të parë, për kompensimin e pagës për fund vitin 2018, dhe 2019 në shumë prej 670.06 euro, për paditësit të dytë, të tretë, të katërt dhe të pestë, në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë të punës, për secilin nga 142.75 euro, si dhe në tërësi refuzohen kërkesat e paditësve, me të cilat kanë kërkuar për ta detyruar të paditurën, që paditësve të ju paguaj në emër të shujtave ditore nga 3 euro (tri), për çdo ditë të prezencës së paditësve në punë, për periudhën kohore 14.11.2018 e deri më datë 23.02.2022 apo për 740 ditë, të punës për secilin paditës, dhe atë për secilin veç e veç, nga 2,220.00 €, si e pabazuar.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur pala e paditur, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe duke marrë për bazë interesin juridik të parashtruesit të ankesës, konsiderohet se i njëjti aktgjykimin e ankimuar e ka goditur pjesërisht dhe atë vetëm sa i përket pikës I të dispozitivit (pjesës aprovuese të kërkesëpadisë), si dhe pikës II (vendosjes për shpenzimet e procedurës dhe kamatë vonesën), me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta prish aktgjykimin e atakuar dhe çështjen ta kthejë çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, apo të njëjtin ta ndryshoj dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj si të pabazuar.

Paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, brenda afatit ligjor, kanë ushtuar përgjegjje në ankesë duke i refuzuar në tërë pretendimet ankimore të të paditurës me propozimin që Gjykata e Apelit ta refuzojë ankesën si të pa bazuar ndërsa aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të të njëjtave, e në kuptim të nenit 194, 195 par.1, pika d), në lidhje me nenin 200 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës, parashtruar përmes përfaqësueses nga Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore në Prishtinë është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit, A. G, S. K, H. Th, V.S. dhe S. M, përmes përfaqësuesit të tyre me autorizim B.P., avokat nga Vushtrria, me datë 14.09.2021 ka ushtuar padi kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme, për kompensimin e pagës së trembëdhjetë, për fund vitet 2018,2019, 2020 dhe 2021, shpërblimit jubilar dhe shujtave ditore, në lartësinë e kërkuar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, si dhe shpenzimet e procedurës.

E paditura, brenda afatit ligjor, përmes përfaqësueses nga Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore në Prishtinë, ka parashtruar përgjigje në padinë me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve, me arsyetim se e njëjta është e palejuar sepse paditësit nuk i kanë shterur mjetet e brendshme të ankimit, ashtu siç parashihet me nenin 78 paragrafi 1 dhe 2 dhe neni 79 i Ligjit Nr.03/L-212 të punës. Tutje ka theksuar se e kundërshton edhe kërkesëpadinë e paditësve për sa u përket kompensimit të pagës së trembëdhjetë, pasi që nuk është realizuar për asnjë punonjës të Policisë së Kosovës, për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Ka shtuar se Ministria e Financave në përputhje me nenin 19 të Ligjit nr.07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, përkatësisht Ligjin nr. 05/L-125, neni 20 paragrafi 4 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, nuk e ka aprovuar kërkesën e Policisë së Kosovës dhe si rrjedhojë, çdo nismë, duke përfshirë edhe atë lidhur me nenin 29 pika 2 të UA nr.02/2018 për Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili prodhon obligime financiare nuk është i obligueshëm përderisa nuk ka identifikuar paraprakisht burimin financiar, ashtu që në mungesë të mjeteve buxhetore – financiare nuk ka mundur të realizohet pagesa e pagës së 13-të. Më tej ka theksuar se pagesat për shujta ditore janë realizuar varësisht prej mjeteve buxhetore të aprovuara dhe atë vetëm për një pjesë të zyrtareve policor të cilët janë të angazhuar në raste të veçanta. Ka shtuar se Udhëzimi Administrativ i të paditurës ku është mbështetur kërkesëpadia e paditësve nuk ka veprim retroaktiv, si dhe nuk është në harmoni me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore, sipas saj Policia e Kosovës, nuk mund të vendos për ndarjet buxhetore me anë të Udhëzimit Administrativ, por ato përcaktohen me anë të ligjit që i nënshtrohen miratimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Si i tillë, UA nr.02/2018 sa i përket implikimeve financiare nuk ka fuqi të prodhoj efekte financiare të cilat nuk janë paraparë me Ligjin mbi Ndarjen e Buxhetit, dhe mbi bazën e kësaj nuk mund të ketë përparësi një udhëzim administrativ ndaj ligjit. Me propozim për Gjykatën që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi, shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, ashtu që ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë si të themeltë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata e shkallës së parë lidhur me mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, ka theksuar se gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, që në këtë rast rezulton se padia e paditësve është pjesërisht e bazuar për arsye se:

Me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) përcaktohet se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”*, lidhur me nenin 4 paragrafi 2 i LPK-së, në të cilin përcaktohet se: *“Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj”*.

Ndërsa për pjesën tjetër të kërkesëpadiës, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 399 sipas të cilit *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin merititor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se: Në mes të palëve ndërgjyqësve nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, megjithatë gjykata këtë e vërtetoi edhe nga vërtetimet e punësimit të bashkangjitura shkresave të lëndës për secilin paditës, të cilat janë të datave 15, 14, 19 prill, 31 mars dhe 15 tetor të vitit 2021.

Nga vërtetimet e punësimit të cekura më lartë gjykata konstatoi se paditësi i parë, e ka filluar punën te e paditura nga data 21.01.2019, dhe realizon pagë mujore në shumë prej 502.50 euro. Paditësi i dytë, e ka filluar punën te e paditura nga data 14.06.2014, dhe realizon pagë mujore, në shumë prej 588.73 euro. Paditësi i tretë e ka filluar punën te e paditura nga data 15.04.2002, dhe realizon pagë mujore, në shumë prej 636.47 euro. Paditësi i katërt e ka filluar punën te e paditura nga data 17.01.2005, dhe realizon pagë mujore në shumë prej 582.84 euro, dhe paditësi pestë e ka filluar punën te e paditura nga data 23.09.2002, dhe realizon pagë mujore, në shumë prej 531.90 euro.

Gjykata, vlerëson se në këtë rast duhet të zbatohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 02/2018 dhe UA nr.01/2021, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, për kërkesat e

aprovuara të paditësve, që kanë të bëjnë me kompensimin e pagës së 13, për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021.

Me nenin 29 paragrafi 2 të UA nr.02/2018 përcaktohet se: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”.*

Me nenin 30 paragrafi 2 të UA nr.01/2021 përcaktohet se: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, nëse ka mjete buxhetore”.*

Nga interpretimi i dispozitave të lart cituara të Udhëzimeve Administrative 02/2018 dhe 01/2021, të nxjerra nga e paditura, dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar sepse paditësit e gëzojnë të drejtën që në fund të çdo viti kalendarik ta përfitojnë si shpërblim një pagë mujore, e cila do të jetë ekuivalente me pagën mujore në fund të vitit kalendarik përkatës, me kusht që atë vit kalendarik punonjësit e të paditurës, në këtë rast paditësit, të kenë vlerësim të kënaqshëm të performancës së punës, nëse nuk ju është shqiptuar ndonjë masë disiplinore brenda vitit përkatës. Në këtë rast sipas formularëve të vlerësimit të performancës, që gjenden në shkresat e lëndës, konstatohet se të gjithë paditësit, kanë vlerësim të kënaqshëm, të performancës dhe të njëjtëve nuk ju është shqiptuar ndonjë masë disiplinore, për gjatë viteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021. Për më tepër e paditura nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje, me anë të përgjigjes në padi, e që do të vinte në dyshim performancën e paditësve për vitet e lartcekura, e po ashtu nga e paditura nuk është ngritur as çështja e ndonjë mase disiplinore eventuale të shqiptuar ndaj ndonjërit prej paditësve. Me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e kompensimit për shpërblimin e pagës së fund viteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021, gjykata mori për bazë vërtetimet e punësimit, të vlerësuara si më lart, për secilin paditës veç e veç, e nga të cilat rezultojnë pagat të cilat i realizojnë paditësit, andaj të njëjtëve për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, iu takojnë secilit veç e veç shumatat ashtu siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, vlerëson se e paditura ka pasur për detyrim sipas dispozitave të lart cituara, që të ua kompensoi paditësve, pagat e 13-ta, për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021. Andaj paditësit e kanë cilësinë e kreditorëve ndërsa e paditura cilësinë e debitorit, bazuar në nenin 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), në të cilin përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura ju ka mbetur borxh paditësve me aplikimin e dispozitave të lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësve të ju kompensoi shumatat e gjetuara, si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Për lartësinë e kamatës në shkallë prej 8%, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 paragrafi 2 i LMD-së, dhe Mendimit Juridik për Kamatat i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 02.12.2020,

duke filluar me llogaritjen e kamatës nga data 17.09.2021, dita e paraqitjes së kërkesëpadisë në këtë gjykatë, e deri në përmbushjen definitive të detyrimeve.

Gjykata ka refuzuar pjesën e kërkesëpadisë së paditësit të parë për kompensimin e pagës për fund vitin 2018 dhe 2019 për arsye se ky paditës është punësuar në vitin 2019 sipas vërtetimit të punësimit të lartcekur, e që për vitet 2018 dhe 2019, nuk i takon ndonjë pagë e 13 siç e ka kërkuar. Gjykata i refuzoi në tërësi kërkesat e paditësit të dytë, të tretë, të katërt dhe të pestë, që kanë të bëjnë me shpërblim jubilar të 25%, të një page bazë, për 10 vite përvojë pune, sepse për paditësin e dytë viti i parë jubilar është arritur në vitin 2014, që në atë kohë dispozitat e udhëzimit administrativ të lart cituara nuk ishin në fuqi, ndërsa vitin tjetër jubilar e arrin në vitin 2024, për paditësin e tretë viti i parë jubilar është arritur në vitin 2012, që në atë kohë dispozitat e udhëzimit administrativ të lart cituara nuk ishin në fuqi, ndërsa vitin tjetër jubilar e arrin në vitin 2022, për paditësin e katërt viti i parë jubilar është arritur në vitin 2015, që në atë kohë dispozitat e udhëzimit administrativ të lart cituara nuk ishin në fuqi, ndërsa vitin tjetër jubilar e arrin në vitin 2025, kurse për paditësin e pestë viti i parë jubilar është arritur në vitin 2012, që në atë kohë dispozitat e udhëzimit administrativ të lart cituara nuk ishin në fuqi, ndërsa vitin tjetër jubilar e arrin në vitin 2022, që për secilin nga këta paditës këto kërkesa ende nuk janë bërë të arritshme.

Gjykata i ka refuzuar në tërësi kërkesat e paditësve për kompensimin e shujtave ditore për gjithsej 740 ditë pune për periudhën kohore nga data 14.11.2018 e deri me 23.02.2022, apo në shumën prej 2,220.00 €, për secilin paditës, sepse me paragrafin 1 të nenit 29 të UA nr.02/2018 si dhe të nenit 30 paragrafi 1 të UA nr.01 /2021, përcaktohet se: *“Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici”*. Pasi që dispozitat ligjore të lart cituar nuk e detyrojnë shprehimisht të paditurën për kompensimin e shujtave ditore ashtu siç kanë kërkuara paditësit, andaj vendosi si në pikën -III-, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës në përgjigje në padi dhe gjeti se të njëjtat janë të pabazuara. E paditura nuk mund ta mënjanoi detyrimin, me pretendim se detyrimet financiare nga Udhëzimi Administrativ, se nuk prodhojnë efekt për shkak se nuk janë në harmoni me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore, gjykata vlerëson se këto akte, në këtë rast Udhëzimet Administrative të lartcekura, janë aprovuar nga struktura të larta të të paditurës, e të cilët e kanë pasur për qëllim edhe motivimin e punonjësve për punë kur edhe kanë përcaktuar shpërblime për të njëjtit. Për më tepër derisa ato janë qartë të specifikuar, nuk mund të interpretohen në dëm të tani paditësve duke u thirrur në ekzistimin e mundësive financiare, e as nuk mund të mbetet në diskrecionin e të paditurës se a mundet apo jo për tu përmbushur detyrimet që rezultojnë nga dispozitat e lartcekura për derisa e paditura me asnjë provë shkresore-analizë buxhetore, nuk e argumenton faktin se ka mungesë të mjeteve buxhetore për përmbushjen e detyrimeve siç kanë kërkuar paditësit, për pjesën e aprovuar të kërkesës.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata është në dispozitën nenit 449 dhe 452 e LPK-së, sipas të cilave paditësve ju pranohen shpenzimet në shumë prej 724.00 €, dhe atë në emër të përpilimit të padisë, shumë prej 624.00 € dhe në emër të taksës për padi shumë prej 100.00 €. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara, meqenëse kompensimi caktohet vetëm për shpenzimet e krijuara lidhur me lëndën në gjykatë. Për më tepër

nuk mund të kërkohet kompensim për secilën parashtrësë të deponuar në gjykatë e posaçërisht jo lidhur me parashtrësën e dorëzuar sipas aktvendimit për plotësimin e padisë, duke qenë se parashtrësja gjegjësisht padia fillestare ka pasur të meta.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, në pikat e atakuara me ankësë, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, e as në shkelje tjera të pretenduara nga pala ankuese, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për themelësinë e pjesërishme të kërkesëpadisë së paditësve, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Aktgjykimi i atakuar me ankesë është i rregullt në pikëpamje të strukturës dhe përmbajtjes duke përfaqësuar kështu një vendim i cili është koherent në pikëpamje logjike dhe juridike duke eliminuar çfarëdo kontradikte për ta kualifikuar si kundërtëhënës. Mënyra e zhvillimit të procedurës dhe e hartimit të vendimit nga gjykata e shkallës së parë kanë garantuar një proces të drejtë dhe të paanshëm duke u mbështetur për përfundimin e saj në themelin faktik dhe juridik të çështjes.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pa bazuara pretendimet ankimore të të paditurit se gjykata e shkallës së parë ka bërë konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ngase gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesërishme të kërkesëpadisë së paditësve, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Si rrjedhojë, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe faktet vendimtare marrëdhënie e punës e paditësit tek e paditura, vlerësimi pozitiv i performacës për paditësit nga e paditura për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021 dhe mungesa e shqiptimit të ndonjë masë në procedurë disiplinore për paditësit e po ashtu edhe lartësia e pagave. E paditura nuk ka arritur të provojë se i ka kompensuar paditësit pagat e kërkuara.

Gjykata e Apelit, analizoi dhe vlerësoi me kujdes pretendimin ankimor të palës së paditur e cila në ankesë ka theksuar se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së Aktgjykimit ankimor ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si pasojë e shkeljeve procedurale të nenit 398 të LPK-së për faktin se nuk ka hapur fare shqyrtim lidhur me prapësimin e të paditurës dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit të atakuar gjeti një pretendim i tillë është i pabazuar.

Nga interpretimi i nenit 398 të LPK-së del se në qoftë se, pas marrjes së përgjigjes në padi, gjykata konstaton se, ndërmjet palëve kontestohen faktet relevante, ajo do të caktojë seancat gjyqësore për vërtetimin e tyre, mirëpo, nëse konstaton se, ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor gjykata mund të japë aktgjykim me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë. Fjala “mundet” e përdorur në këtë dispozitë e lë në diskrecionin e gjykatës dhënien e aktgjykimit të tillë, mirëpo, meqenëse ligjdhënësi me këtë zgjidhje ligjore ka synuar që në rastet kur gjendja faktike është e qartë dhe jo kontestuese ndërmjet palëve, procedura gjyqësore duhet të përfundojë në afatin sa më të shkurtër dhe me sa më pak shpenzime, rezulton se gjykatat do të duhej që të jepnin aktgjykimin pa procedim të mëtejshëm, sa herë që plotësohen kushtet e parapara me këtë dispozitë. Në këtë rast aktgjykimi ankimor nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga nenit 182 paragrafi 2 pika n) për faktin se gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar i ka dhënë arsyet lidhur me prapësimin e të paditurës për parashkrimin e kërkesës në këtë çështje kontestimore të cilat arsye Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i pranon si të drejta dhe ligjore.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurit se kërkesëpadija e paditësve duhet të hudhet si e palejuar për shkak se nuk i kanë shtjerr mundësitë e ankesës brenda institucionit të të paditurës në kuptim të nenit 78 dhe nenit 79 të Ligjit të Punës. Gjykata e Apelit thekson se e drejta e punës është kategori kushtetuese e garantuar me konventa ndërkombëtare dhe me ligj, dhe në rast të paraqitjes së kërkesës së punonjësit për kompensim dëmi apo në kërkesat e tjera në të holla-para nga marrëdhënia e punës (*kërkesat materiale*) punonjësi nuk ka nevojë që paraprakisht t’i drejtohet punëdhënësit me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij si kusht themelor për parashkrimin e padisë në gjykatë, (sepse në rastin konkret nuk bëhet fjalë për procedurat për realizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës ku aplikohet neni 78, neni 79 dhe neni 82 i Ligjit të Punës) e kjo duke u bazuar në nenit 87 të Ligjit të Punës, pasi që me dispozitën e këtij neni është paraparë qartë se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, andaj nga kjo dispozitë rezulton se paditësit në asnjë rrethanë nuk mund ti mohohet e drejta për të kërkuar mbrojtje gjyqësore pa i shtjerr mjetet juridike tek e paditura.

Gjykata e Apelit i refuzon si të pa bazuara pretendimet ankimore të palës së paditur e cila në ankesë thekson se kompensimin e pagës së 13-të do ta bënin vetën në bazë të mundësive buxhetore të punëdhënësit ngase asnjë dispozitë ligjore nuk e parasheh si detyrim ligjor, se me qëllim të sigurimit të mjeteve buxhetore për realizimin e kësaj pagese, Policia e Kosovës me datë 24.10.2017 përmes Ministrisë së Punëve të Brendshme ka parashtruar kërkesë buxhetore sipas Qarkores Ref 2018/02 për periudhën 2018-2020 që të ndahet një shumë e caktuar e mjeteve për mbulimin e kërkesave të tilla, kërkesa e Policisë së Kosovës nuk është aprovuar nga ana e autoritetit miratues- Ministrisë së Financave. Këto pretendime e paditura nuk i ka mbështetur me asnjë provë konfirmuese nenit 7 lidhur me nenin 319 të LPK-së ku parashihet se *“secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*, për më tepër çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e Udhëzimit Administrativ 02/2018, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësit, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadija të trajtohet si e pa themeltë.

Nuk qëndron pretendimi ankimor në raport me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale pasi që me Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës dhe atë me nenin 29 paragrafi 1 tek e drejta në pagë dhe e shpërblimit, përcaktohet se *“Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici”*, ndërsa me të njëjtin, nen paragrafi 2 përcaktohet se *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”*.

Paditësit i plotësojnë kushtet për të përfituar një kompensim të tillë, pasi që janë në marrëdhënie pune të e paditura, nuk kanë pasur masë disiplinore të shqiptuar për vitet kontestueses, 2018, 2019, 2020 dhe 2021, ndërsa kanë pasur vlerësim të mirë për këto vite, lartësia e pagës është përcaktuar në bazë të listës së pagave për vitet, 2018, 2019, 2020 dhe 2021 si dokument publik lëshuar nga e paditura.

Pretendimi për mungesë buxheti apo mos harmonizimi i Udhëzimit Administrativ me Ligjin për buxhetin është aspekt i brendshëm i të paditurës me organet e veta, pastaj përderisa Udhëzimi ka qenë në fuqi, e paditura nuk mund t'i shmanget detyrimit për përmbushje.

Sipas Gjykatës së Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, personeli i policisë ka të drejtë në shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: që personelit të policisë që kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës bazuar në udhëzimin Administrativ numër 02/2018 i cili ka hyrë në fuqi me datë 14.11.2018 si dhe Udhëzimi Administrativ 01/2021 i cili ka hyrë në fuqi me datë 29.09.2021 i cili e ka shfryqizuar Udhëzimi Administrativ nr.02/2018, mirëpo sipas kësaj gjykate, personeli i policisë kanë të drejtë që edhe për vitin 2021, të përfitojnë shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, nëse plotësohen kushtet e theksuara si më lartë, për arsye se neni 29 paragrafi 2 i Udhëzimit Administrativ nr.02/2018, ka qenë në fuqi deri më datën 29.09.2021, dhe ka qenë i katarakterit detyrues, sipas të cilit punëdhënësi ka qenë i obliguar që edhe për vitin 2021, të planifikojë mjetet buxhetore, ndërsa është i papranueshëm çdo arsyetim eventual për mungesë të mjeteve buxhetore. Kjo çështje është sqaruar edhe përmes Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës numër 213/2023 e datës 09.10.2023, ku përcaktohet e drejta e personelit të policisë në kompensimin e pagës së trembëdhjetë me plotësimin e kushteve ligjore si më lartë.

Gjithashtu, edhe vendosja lidhur me kamatëvonesën, është në përputhje të plotë me nenin 382 të LMD-së, i cili përcakton detyrimin e debitorit në pagesën e kamatëvonesës si pasojë e vonesës në përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit, e në rastin konkret e paditura meqë, është vonuar dhe nuk ka përmbushë detyrimin e saj ndaj kreditorit në afatin e përcaktuar me kontratë kolektive, atëherë e njëjta i detyrohet në përmbushjen e detyrimit së bashku me kamatëvonesën në shkallë prej 8% vjetore, nga data e ushtrimit të padisë e gjer në përmbushjen definitive të detyrimit.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat nenit e 452 të LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifatat për shpenzime gjyqësore.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të paditurës, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Meqë, aktgjykimi i ankimuar nuk është goditur me ankesë në pikën **III** të dispozitivit të tij nga pala me interes juridik, gjykata e shkallës së dytë, duke iu përmbajtur kufizimit ligjor të mjetit juridik (kufinj të ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar), sipas nenit 194 të LPK-së, si dhe Institutit “Reformatio in Peius” nga neni 203 i LPK-së, këtë pikë të aktgjykimit të ankimuar nuk e shqyrtoi fare.

Gjykata i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat ishin pa ndikim për një vendimmarrje ndryshe nga ajo që u vendos në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par. 1 pika d) të LPK-së, lidhur me neni 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.2867/23, datë 12.03.2024

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari,
Besnik Feka